



Në cilat raste fëmijët e sëmurë nuk duhet të vijnë në kopsht ose në shkollë, por duhet të qëndrojnë në shtëpi??




1. A i është shfaqur fëmijës suaj temperaturë, kollë, dhimbje fyti, rrjedhje hundësh në 24 orët e fundit?



- Mbajeni në shtëpi fëmijën.
- Fëmija duhet të bëjë testin për COVID-19.

Nëse fëmija ka rrjedhje nga hundët ose mukozë/gëlbazë ose nuk ndihet mirë, fëmija mund të shkojë në kopsht/shkollë dhe nuk është e nevojshme të bëjë testin e COVID-19. Kjo vlen edhe nëse fëmija ka ndonjë alergji që dihet.




Telefononi mjekun nëse fëmija është ftohur, dhe:

- Fëmija nuk dëshiron të luajë ose nuk është aktiv.
- Fëmija ka temperaturë, dhimbje muskulore, rënie të oreksit, letargji, përzierje ose marrje mendsh.
- Fëmija ka vështirësi në frymëmarrje dhe/ose merr frymë më shpejt se normalisht kur nuk është duke bërë aktivitet.

Mos harroni se fëmijët e vegjël nuk e shpjegojnë dot si ndihen, ata mund të grinden, të kapen pas prindit ose të inatosen lehtë. Nëse jeni në merak për fëmijën tuaj të sëmurë, duhet të kontaktoni mjekun ose shërbimin mjekësor që operon jashtë orarit të punës.

2. A e konfirmon testi COVID-19?



PO

Fëmija duhet të qëndrojë në shtëpi. Komuna do t'ju tregojë se cilat rregulla ju dhe familja juaj duhet të ndiqni ndërkohë që fëmija është sëmurë.



JO.

Fëmija mund të shkojë në kopsht ose në shkollë kur të jetë më mirë dhe të mos ketë temperaturë. Fëmija mund të shkojë në kopsht ose në shkollë edhe nëse ka simptoma të lehta, si mukozë/qurra, janë pak të ngjirur ose kanë kollë të lehtë.